



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit –Ured Premijera –Office of the Prime Minister

Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistiku Kosova - Kosovo Agency of Statistics

Duke u bazuar ne Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civilë te Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2010 Procedurat e Rekrutimit ne Shërbimin Civil te Republikës se Kosovës , *Agjencia e Statistikave të Kosovës* shpallë:

KONKURS

Departamenti i Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit , një (1) pozitë të karrierës:

Titulli: Një (1) Zyrtar për statistika të mjedisit

Numri i referencës : ASK-DSBM-001

Koeficienti :6

Detyrat dhe përgjegjësit :

- Përgatit metodologjinë e hulumtimeve statistikore mjedisore në përgjithësi,
- Publikon të dhënat e indikatorëve mjedisor siç janë: ujit, ajrit, tokës, biodiversitetit dhe mbetjeve.
- Përgatit pyetësorët e anketave, udhëzimet për anketues, bën trajnimin e anketuesve, monitorimin e punëve në terren, kontrollimin e të dhënave, të materialit, sistemimin e tij,
- Shfrytëzon metodologjitë dhe nomenklaturat e Eurostatit, rregulloret e BE-së
- Punon në përpunimin, analizën e të dhënave, kryen punët sipas planit të punës dhe dinamikës së paraparë,
- Përgatitja e publikimeve për statistikatat e mjedisit,
- Është përgjegjës për cilësinë e të dhënave dhe dërgimin e të dhënave mjedisore në Eurostat me programin Edamis
- Siguron krahasueshmërinë ndërkombëtare të të dhënave statistikore mjedisore.
- Kryen edhe punë tjera qe i ipen nga ana e eprorit të tij.

-Kualifikimi shkollor: Diploma universitare nga Fakulteti i bujqësisë dhe shkencave matematiko natyrore –departamenti i biologjisë (ekologji dhe mbrojtje e mjedisit).

- Përvoja e punës: kandidati duhet te ketë 2 vite përvojë pune.

-Shkathësitë, aftësitë e nevojshme:

- Aftësi të punës në kompjuter (Word, Excel, Acces, SPSS etj) ,
- Aftësi të lartë të bashkëpunimit në grup,

-Njohës i indikatorëve të mjedisit,

-Azhur dhe i gatshëm në kryerjen e detyrave.

-Njohje të gjuhës Angleze

Procedura e konkurimit:

Në Shërbimin Civil kanë të drejtë të punësohen shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore ,të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, përgatitje të nevojshme arsimore dhe aftësi profesionale për zbatimin e funksionit administrativ dhe të cilët kanë aftësi fizike që kërkohen për pozitën përkatëse.

Aktet ligjore dhe nënligjore që e rregullojnë rekrutimin:

Përzgjedhja e Shërbyesve Civilë bëhet në pajtim me Ligjin –Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e rekrutimit në Shërbimin Civil.

Kohëzgjatja e emërimit: Sipas Ligjit të Shërbimit Civil të Republikës së Kosovës , në të cilën është përfshirë periudha e punës provuese prej një (1) viti.

Konkursi është i hapur 15 dite kalendarik nga dita e publikimit në mjetet e informimit publik.

Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve:

Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Agjencionin e Statistikave të Kosovës , Rr, ”Zenel Salihu” nr.4 Prishtinë. Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, dëshmi

mbi përvojën e punës , vërtetimin nga Gjykata që personi nuk është nën hetime dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme , që kërkohen për vendin e punës për të cilin konkurohi. Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara do të refuzohen.

Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar , vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të nënshtrohen testimit me shkrim dhe intervistimit.

Për informata të hollësishme, mund të kontaktoni me zyrën e personelit , në tel: 038- 20031149 , prej orës 08:00 – 16: 00.

“Shërbimi Civilë i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

“Komuniteti jo - shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në Nenin11, paragrafin 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës”.